



Pjesëtar i Komisionit Prishtinë/Prishtina Prishtinë/Prishtina		25.11.2021	1	115
Emri i Personit Organizata Org. Shkollor	Nr. Pjesë Nr. Pjesë Prishtinë	Shkollor Prishtinë	Seksi Kategoria Detyrimi	
SHABANI		5676/2021		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.834/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtar dhe Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.834/2021 të datës 28.09.2021 të parashtruar nga ankuesit

të përfaqësuar nga avokat me adresë rruga "Sadik Stavileci", Nr.41/A, Komuna e Gjakovës, kundër organit të punësimit/Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 24.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.834/2021 e datës 28.09.2021 e parshtruar nga ankuesit dhe e parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve.

II. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.834/2021 e datës 28.09.2021 e parashtruar nga ankuesit dhe e parashtruar nga përfaqësuesi i ankuesve.

A r s y e t i m

Ankuesit

nëpërmjet përfaqësuesit të tyre përmes Postës së Kosovës, me datën 24.09.2021 ,kanë parashtruar ankesë me Nr.Prot: 4787/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ,e cila në Këshill është pranuar me datën 28.09.2021 me pretendimet ankimore për kompensim të pagave jubilarë, pagave përcjellëse pas pensionimit, pagave të trembëdhjeta dhe shujtave ditore për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018 sipas Kontratës Kolektive të Kosovës të vitit 2015.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 29.09.2021, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Komunën e Gjakovës. Me datën 22.10.2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Gjakovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.Prot:4787/2021 të datës 28.09.2021 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për kompensim e datës 19.07.2021 nga avokati i ankuesve drejtuar Komunës së Gjakovës; Autorizim i datës 17.06.2021 për ankuesin Autorizim i datës 18.06.2021 për ankuesen
Autorizim i datës 18.06.2021 Autorizim i datës 18.06.2021 për ankuesen
Autorizim i datës 21.06.2021 për ankuesin Autorizim i datës 17.06.2021 për ankuesin
Autorizim i datës 19.07.2021 për ankuesen Autorizim i datës 19.07.2021 për ankuesen
Autorizim i datës 18.06.2021 për ankuesin Autorizim i datës 01.06.2021 për ankuesin Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 29.09.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigja në ankesë e datës 22.10.2021 nga Komuna e Gjakovës me shkresat e bashkangjitura; Akt emërim i ankuesit i datës 01.04.2012; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit të ankueses i datës 01.07.2019; Akt emërim i ankueses i datës 01.02.2012; Akt emërim i ankuesit i datës 01.03.2012; Akt emërim i ankuesit i datës 01.08.2012; Akt emërim i ankuesit i datës 01.03.2012; Akt emërim i ankueses i datës 01.03.2012; Akt emërim i ankueses i datës 12.03.2012; Akt emërim i ankuesit i datës 01.03.2012; Përgjigje në kërkesë e datës 01.10.2021 nga Komuna e Gjakovës; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil. Vendim me numër 01 Nr.118/01-11147 për pensionim për ankuesin Vendim me numër 01 Nr.118/02-44712 për pensionim për ankuesen Vendim me numër 01 Nr.118/02-38414 për pensionim për ankuesin
Vendim me numër 01 Nr.01-400/01-17638 për pensionim për ankuesen Dëshmi për pagesat e pagave përcjellëse me rastin e pensionimit për ankuesit dhe

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesit dhe është parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka analizuar shkresat e lëndës të ofruara nga ankuesit dhe organi i punësimit ka konstatuar si ne vijim se : ankueses në pozitën e punës "Punëtore administrative" në Drejtorinë për Shërbime Publike në Komunën e Gjakovës, në bazë të vendimit me numër 01Nr.118/02-44712, i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 02.02.2020 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; ankueses në pozitën e punës "Punëtore administrative dhe punë kompjuterike" në Drejtorinë për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës, në bazë të vendimit me numër 01Nr.118/01-11147,

i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 10.08.2020 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit; ankuesit në pozitën e punës "Inspektor sanitar" në Drejtorinë për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës, në bazë të vendimit me numër 01Nr. 118/02-38414, i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datën 23.10.2019 dhe ankueses në pozitën e punës "Inspektore e tregut" në Drejtorinë për Punë Inspektuese në Komunën e Gjakovës në bazë të vendimit me numër 01Nr.01-400/01-17638, i ka përfunduar marrëdhënia e punës me datën 23.06.2019, e qe ankuesit prej datës kur janë pensionuar e deri tek data 19.07.2021 kur me kërkesë i'u kane drejtuar Komunës së Gjakovës lidhur me kompensimin e pagave jubilarë dhe pagesës se tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit sipas pagave me rastin e pensionimit, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, nuk kanë ndërmarr asnjë veprim ligjor, respektivisht ankuesit nuk kanë ofruar asnjë dëshmi që kanë parashtruar ankesë në kuadër të institucionit të punësimit, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, respektivisht me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave ku përcaktohet se: *"Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në bazë të Vendimeve për pensionim ankuesve marrëdhënia e punës ju ka përfunduar për shkak të arritjes së moshës së pensionimit si ne vijim: ankueses nga data 02.02.2020, ankueses nga data 10.08.2020, ankuesit nga data 23.10.2019 dhe ankueses nga data 23.06.2019, ndërsa me datën 28.09.2021 ankuesit kane parashtruar ankesë me numër protokollit 4787/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *jashtë afatit ligjor* të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*, në kuptim të kësaj dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankesa e ankuesve dhe është e palejuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në pikën 1 të dispozitivit të këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesve dhe është e pabazuar, sepse:

Ankuesit të punësuar në Komunën e Gjakovës në pozita të nëpunësve civilë, përmes përfaqësuesit të tyre me datën 19.07.2021 kanë parashtruar kërkesë në Komunën e Gjakovës për kompensimin e shujtës ditore, shpërblimeve jubilarë dhe pagës së trembëdhjetë. Komuna e Gjakovës, deri me datën 01.10.2021 nuk ka kthyer përgjigje tek përfaqësuesi i ankuesve, me arsyetimin se si pasojë e pandemisë Covid 19 kanë punuar me staf esencial javët e fundit. Në

lidhje me kërkesën e përfaqësuesit të ankuesve për kompensim material, Komuna e Gjakovës ka dhënë përgjigje duke cituar se *"planifikimi i pagave bëhet duke u mbështetur në limitet e kategorive ekonomike të përcaktuara nga qarkoret buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave, andaj edhe vlera e përcaktuar për kategorinë paga dhe mëditje nga qarkoret buxhetore nuk na lejon të buxhetojmë shtesa të tilla sepse ju dedikohet vetëm pagave të rregullta"*.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes përfaqësuesit të tyre, kanë parashtruar ankesë kundër heshtjes administrative të Komunës së Gjakovës lidhur me kërkesën e tyre për kompensim material dhe pretendojnë që Komuna e Gjakovës nuk i ka përmbushur detyrimet të cilat dalin nga Marrëveshja Kolektive, meqë nuk ka bërë kompensim të pagave jubilarë, pagës së trembëdhjetë dhe shujtave ditore për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: *"Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet"*, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: *"Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës"*, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje me datën 15.09.2017, ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës përcakton se: *"Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit"*, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Në momentin kur ka filluar të zbatohet Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka qenë i zbatueshëm Ligji Nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative i cili ka përcaktuar edhe afatet ligjore për parashtrim të ankesës, ku në nenin 130.1 pika b, përcakton se: *"Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi"*, kështu që Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ka qenë publike (e publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës), ke me këtë rast të gjithë të punësuarit kanë qenë të njoftuar me të drejtat që rrjedhin prej saj. Bazuar në provat e lëndës ankuesit nuk kanë dëshmuar që në kohën sa ka qenë e zbatueshme Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, kanë parashtruar kërkesë apo ankesë në Komunën e Gjakovës lidhur me pretendimet e tyre ankimore, ndërsa nëse i referohemi kërkesës së datë 19.07.2021 të parashtruar nga ankuesit pranë Komunës së Gjakovës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se ankuesit fillimin e ankimit e kanë bërë pas një kohe më shumë se tri (3) vite nga momenti kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshme në Republikën e Kosovës.


Neni 125 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcaktohet se: "Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")", rrjedhimisht Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankuesit lidhur me pretendimet ankimore të tyre, procesin e ankimimit e kanë filluar në kundërshtim me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ", kështu që pretendimet ankimore të ankuesve janë të pabazuara.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.834/2021

Ardita Perçuku-Shyti


Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës ;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.